ISSN 2521-831X

Nr.9

BULETINI MUJOR KLIMATIK

Shtator 2017

Universiteti Politeknik i Tiranës

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit & Mjedisit

Tirana © 2017

ISSN 2521-831X

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
INSTITUTI I GJEOSHKENCAVE DHE ENERGJISË, UJIT DHE MJEDISIT
Adresa: Rr. "Don Bosko", Nr.60, Tiranë. Tel /Faks: 00355 4 2259540 Web site: http://www.geo.edu.al
Klima.Shqiperia@gmail.com

BULETINI MUJOR KLIMATIK

Shtator 2017

Nr. 9

Vlerësimi meteorologjik për muajin Shtator 2017

Përmbledhje: *Muaji Shtator 2017, referuar klimës së vendit tonë, u karakterizua përgjithësisht me treguesit tipikë të stinës së vjeshtës. Temperaturat e ajrit shënuan vlera pranë normës, por u karakterizuan me vlera të amplitudave rreth +2.0°C më të larta se norma. Reshjet në tërësi ishin më të larta se norma me rreth 27% dhe u shpërndanë në një numër ditësh më të lartë (+3 ditë) ose me rreth 55% më shumë, sa i takon treguesit të numrit të ditëve me reshje mbi pragun 1.0 mm.*

Summary: *The month of September 2017, referring to the climate of our country, has been characterized by typical indexes of autumn season. The air temperatures got approximately to the norm values; but their amplitudes was about +2.0°C higher than the norm values. The precipitation in general have been higher by 27% than the norm values and distributed by more rainy days (+3 days) or 55% higher compare to the index of rainy days over the threshold value of 1.0 mm.*

Muaji Shtator 2017 është dominuar nga moti i paqëndrueshëm, i gjeneruar nga 3 fronte, të cilat kaluan mbi vendin tonë në datat 3, 11, 20. Në figurën e mëposhtme paraqitet situata sinoptike e frontit që solli më shumë reshje, ai i datës 11. Ky front kishte parametrat më të lartë sa i takon elementeve atmosferikë më intensivë si erë e fortë, breshër me dimensione të mëdha si dhe pati edhe raportime stuhish në vendet e rajonit.



Figura Nr. 1 – Situata sinoptike e datës 11 shtator 2017.

Në figurat Nr.2/1÷2/12 jepen të dhënat e temperaturave maksimale e minimale ditore të ajrit dhe reshjet e vrojtuara në disa vendmatje meteorologjike përfaqësuese të territorit të vendit tonë.

Vlerësime për ecurinë e temperaturës së ajrit dhe reshjet (figurat në vijim Nr. 2/1÷2/12) në disa prej vendmatjeve meteorologjike të **Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik** për muajin shtator 2017.

























Muaji shtator 2017 u karakterizua menjëherë pas dy ditëve të para, me një tendencë ulje graduale të temperaturave dhe kthimin nga pikëpamja klimatike në karakteristikat tipike të tij. Të dhënat e vlerësuara dhe përpunuara për vendmatjet meteorologjike të vendit tonë tregojnë për vlera pranë normës ose lehtësisht mbi të mesatarisht (+0.1°C) në pak stacione sa i takon temperaturave të ajrit, ndërkohë që reshjet shënuan vlera rreth 27% mbi normë. Ato u shpërndanë me një numër ditësh me reshje mbi pragun 1.0 mm prej rreth 55% më të lartë se norma. Pra, muaj shtator në tërësi u paraqit një muaj i lagësht dhe me temperatura të moderuara, pas gjithë asaj stine vere të nxehtë e të thatë.

Temperaturat e ajrit në mënyrë më të detajuar analizohen nëpërmjet treguesve të ndryshëm meteorologjikë dhe paraqiten në grafikët e dhënë në figurat në vijim.

Në figurën Nr. 3 të dhënat e temperaturës mesatare të ajrit për disa vendmatje të përzgjedhura meteorologjike nga gjithë territori evidentojnë se ato me ndryshime të lehta janë luhatur rreth vlerave të normës.



Figura Nr.3. Temperaturat mesatare të ajrit për muajin shtator 2017 për disa vendmatje të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik.

Për vendmatjen meteorologjike të kryeqytetit të dhënat e muajt shtator 2017 tregojnë për një vlerë -0.8°C më të ulët se norma. Ato paraqiten në figurën Nr. 4 së bashku me vlerat e muajve shtator për vitet e mëparshme 2012 - 2016.



Figura Nr.4. Temperatura mesatare e ajrit për muajin shtator për vitet 2012-2017 për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.

Natyrisht një informacion më i detajuar meteorologjik merret nga vendmatjet elektronike, të cilat nëpërmjet sensorëve të ndryshëm evidentojnë në fragmente më të shkurtra kohore të dhëna për elementë të ndryshëm meteorologjikë, të cilët paraqiten me interes sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Për ilustrim në figurën Nr. 5 jepen të dhënat e marra nga një vendmatje meteorologjike automatike e instaluar në Peshkopi.



Figura Nr.5. Ecuria e temperatura të ajrit për muajin shtator 2017 për vendmatjen meteorologjike automatike të Peshkopisë.

Një vështrim i shkurtër mbi ecurinë dhe vlerat e temperaturave ekstreme minimale dhe maksimale tregon se këto vlera gjatë muajit shtator 2017 nuk arritën nivele për të përcjellë problematika apo dukuri të dëmshme për ekonominë apo jetën e njerëzve. Në figurën Nr. 6 dhe Nr. 7 jepen të dhënat e vlerave minimale dhe maksimale absolute të vrojtuara gjatë muajit shtator për 43 vendmatje meteorologjike.



Figura Nr.6. Vlerat e temperaturave maksimale absolute të ajrit për muajin shtator të vrojtuara në disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë.



Figura Nr.7. Vlerat e temperaturave minimale absolute të ajrit për muajin shtator të vrojtuara në disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë.

Ndërkohë, duhet evidentuar fakti se ndonëse temperaturat mesatare ruajtën vlera pranë normës dhe me ndryshime të vogla, vlerat mesatare të temperaturave maksimale u karakterizuan me një rritje prej afro +1.0°C kundrejt normës, ndërsa ato minimale me vlera rreth -0.8°C nën normë.

Figura Nr.8. Vlerat mesatare të temperaturave maksimale të ajrit për muajin shtator të



vrojtuara në disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë.

Kjo ecuri e vlerave të temperaturave maksimale e minimale përcolli kësisoj një amplitudë më të madhe të temperaturave të ajrit për muajin shtator me rreth +2°C, e cila në kontekstin agrometeorologjik mund të konsiderohet si një gjë pozitive në ecurinë e klimës për këtë muaj.

Të dhënat e amplitudës së temperaturave të ajrit paraqiten në vijim në figurën Nr.10.



Figura Nr.9. Vlerat mesatare të temperatura minimale të ajrit për muajin shtator të vrojtuara në disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë.



Figura Nr. 10. Të dhënat e amplitudës për disa vendmatje meteorologjike të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik.

Reshjet atmosferike të munguara për një periudhë të gjatë kohore gjatë stinës së verës u rikthyen në muajin shtator duke shënuar vlera mbi normë. Në tabelën në vijim Nr.1 jepen të dhënat e reshjeve për muajin shtator 2017 për 62 vendmatje meteorologjike të përpunuara e kontrolluara sipas standardeve të Organizatës Botërore të Meteorologjisë (OBM).

Gjithashtu në figurën Nr. 11 jepet dhe një paraqitje grafike dhe krahasimi me vlerat e normës referuar periudhës 1961-1990.



Figura Nr.11. Vlerat e reshjeve për muajin shtator 2017 të vrojtuara në disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë dhe ato të normës referuar periudhës 1961-1990.

Numri maksimal i ditëve me reshje ishte 12 deri 13. Mesatarisht në shkallë vendi u vrojtuan afro 8 ditë me reshje mbi pragun 1.0 mm ose 3 ditë më shumë se vlerat e normës për këtë tregues meteorologjik ose rreth 55% më shumë. Të dhënat në fjalë dhe krahasimi me vlerat përkatëse të normës klimatike jepen në figurën Nr. 12.



Figura Nr.12. Vlerat e treguesit të numrit të ditëve me reshje mbi pragun 1.0 mm për muajin shtator 2017 të vrojtuara në disa vendmatje meteorologjike dhe ato të normës.

Tabela Nr. 1. Reshjet e vrojtuara gjatë muajit shtator 2017.

Nr.	Vendmatja meteorologjike	Reshje (në mm)	Nr.	Vendmatja meteorologjike	Reshje (në mm)
1	Ballsh	154.0	32	Likmetaj	202.0
2	Belsh	68.8	33	Liqenas	51.6
3	Bilisht	22.3	34	Llongo	51
4	Brataj	234.9	35	Macukull	109.2
5	Burrel	16.0	36	Mashterkorë	103.9
6	Bushat	136.5	37	Narel	28.2
7	Çukë	93.4	38	Nivicë	191.0
8	Dajç Bunë	26.0	39	Orikum	197.5
9	Dajt Fshat	139.9	40	Peqin	124.0
10	Dardhë	56.1	41	Përmet	69.5
11	Dushar	80.7	42	Përrenjas	67.7
12	Ersekë	43.6	43	Petkaj	99.0
13	Fier	89.1	44	Petrelë	146.2
14	Fratar	114.0	45	Petresh	82.7
15	Gojan	99.8	46	Pogradec	54.1
16	Goricë M.	120.5	47	Pukë	114.3
17	Hoshtevë	120.5	48	Qarrishtë	65.8
18	Hot	108.0	49	Selenicë	5.5
19	Jaronisht	109.0	50	Sheqeras	32.2
20	Kalimash	123.0	51	Shishtavec	18.2
21	Kallmet	76.1	52	Shkodër	129.0
22	Kardhiq	113.3	53	Shmil	112.3
23	Klos	72.5	54	Shupenzë	48.9
24	Konispol	28.5	55	Sinjë	107.8
25	Koplik	114.9	56	Sukth	100.0
26	Krahës	133.8	57	Tirana	139.8
27	Krujë	138.1	58	Tropojë	56.0
28	Kryevidh	129.0	59	Vergo	49.0
29	Kuç	181.1	60	Vrith	49.0
30	Kurbnesh	95.0	61	Zarrë	0.0
31	Librazhd	49.5	62	Zerqan	97.9

Ndonëse në tërësi reshjet ishin më të larta dhe të shpërndara në një numër më të lartë ditësh, ato nuk u karakterizuan me intensitete të larta dhe nuk përcollën problematika sa i takon ndonjë përmbytje të mundshme apo dukurive për erozion intensiv.

Në figurën Nr.13. jepen të dhënat e vlerave të reshjeve maksimale 24 orëshe të vrojtuara gjatë muajit shtator 2017 si dhe vlerat historike të regjistruara për këtë muaj në të shkuarën.

Siç shihet në shumicën e vendmatjeve të përpunuara dhe analizuara vlerat e reshjeve 24 orëshe të matura në stacionet meteorologjike të vendit tonë janë dukshëm larg vlerave të rekordeve të mëparshëm historikë për këtë muaj.

Reshjet më të shumta gjatë muajit shtator 2017 u vrojtuan në pjesën Jugë Perëndimore të vendit, ku në vendmatjet meteorologjike u shënuan këto vlera: në Brataj 234.9 mm, Orikum 197.5 mm, Nivicë 191.0 mm, Kuç 181.1 mm; ndërkohë që një zonë tjetër me reshje i takon pjesës qendrore të vendit ku dalin në pah vendmatjet në: Likmetaj 202.9 mm, Petrelë 146.2 mm, Dajt Fshat 139.9 mm, Tiranë 139.8 mm, Krujë 138.1 mm dhe Peqin 14.0 mm.

Figura Nr.13. Vlerat e reshjeve maksimale 24 orëshe për muajin shtator të vrojtuara në disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë dhe ato të rekordeve historike.

VLERËSIME MBI SITUATËN METEOROLOGJIKE TË PRITSHME PËR MUAJT NË VIJIM.

TEMPERATURA E AJRIT - Muajt e parë të vitit 2018 pritet të karakterizohen në tërësi në shkallë kontinentale me vlera të temperaturave të ajrit mbi normë. Kjo në një masë të caktuar vërehet dhe për vendet pranë rajonit tonë. Sa i takon Shqipërisë nuk evidentohet ndonjë prirje për të patur një vlerësim të ngjashëm me pjesën e veriut të kontinentit sipas këtyre modeleve.

Gjithsesi duke patur në konsideratë disa elementë si: ecurinë e viteve të fundit të motit për këtë hapësirë, faktin që madhësia e vendit tonë është relativisht e vogël përkundrejt asaj të kontinentit, që pjesa më e madhe e tij do ketë prirje për të qenë mbi normë, si dhe aq më tepër duke ditur se masat ajrore mbizotëruese gjatë këtyre muajve e kanë origjinën nga qendra me presion të ulët atmosferik e Islandës, të cilat më pas në sajë të qarkullimit të atmosferës zhvendosen në kontinent; profesionalisht mund të konkludohet për një periudhë relativisht të butë, dhe në se do të verifikohen periudha të ftohta ato do të jenë të shkurtra në kohë dhe të kufizuara në hapësirë.



Figura Nr.14. Vlerësime për probabilitet e temperaturave të ajrit që do të karakterizojnë tre muajt e parë të vitit 2018.

RESHJET ATMOSFERIKE – gjatë muajve janar – mars 2018 siç është evidentuar dhe në buletinet e mëparshme, nuk pritet të ketë vlera mbi normë, por më shumë gjasa janë të kemi periudhë me thatësirë dimërore. Ndërkohë, pjesa veriore e kontinentit pritet të ketë më shumë reshje se norma dhe për këtë periudhë të vitit natyrisht mund të krijojë dhe situata përmbytje.

Sa i takon hapësirës së Ballkanit Perëndimor duket të ketë mundësi të shprehura me vlerat e probabiliteteve për kategoritë me reshje nën normë, ku përfshihet dhe një pjesë e mirë e vendit tonë.



Figura Nr.15. Vlerësime për reshjet atmosferike që do të karakterizojnë tre muajt e parë të vitit 2018.

INFORMACIONE TË TJERA

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I SHPËRNDARJES SË NDOTËSAVE NË LUMIN SHKUMBIN NGA DAMBA E KOMBINATIT METALURGJIK ELBASAN DERI NË GRYKËDERDHJEN E TIJ (*).

Studimi ka për qëllim identifikimin e problemit të ndotjes së ujërave sipërfaqësorë. Për specifikën që ka lumi Shkumbin si dhe rëndësinë në përdorimin e ujërave të tij del e domosdoshme të ndiqet në vazhdimësi, niveli i cilësisë së ujërave dhe i shkallës së ndotjes. Studimi është kryer gjatë viteve 2011 – 2013 në pellgun ujëmbledhës të lumit Shkumbin duke përzgjedhur tetë stacione si pika përfaqësuese të rrjedhës kryesore të lumit Shkumbin dhe të degëzimeve të tij. Metoda e përdorur për shpërndarjen e ndotësve është IDW (Inverse Distance Wighted), e cila njihet edhe si metoda e distancës së peshuar. Metoda e distancës inverse është një metodë lokale interpolimi, e cila merr në konsideratë parimin e influencës në raport me distancën, d.m.th në një pikë të panjohur pikat e afërta kanë më shumë influencë se pikat e largëta dhe influenca zvogëlohet me rritjen e distancës.



Sh 1 (Fushë Labinot) **Sh 2** (Para K. Metalurgj)
Sh 3 (K. Metalurgj) **Sh 4** (Uzina Ferrokromit)
Sh 5 (Ura e Papërit) **Sh 6** (Ura e Peqinit)
Sh 7 (Ura e Rrogozhinës) **Sh 8** (Grykëderdhja)

Figura Nr.16. Pellgu ujëmblëdhës dhe stacionet e monitorimit.



Figura Nr.17. Shpërndarja hapësinore e vlerave mesatare të F.P mg/l$CaCO_3$.



Figura Nr.18. Shpërndarja hapësinore e vlerave mesatare të BTEX-ve µg/l.



Figura Nr.19. Shpërndarja hapësinore e vlerave mesatare të Ni µg/l.

Figura Nr. 20. Shpërndarja hapësinore e vlerave mesatare të K.F cfu/100ml.

Në këtë studim, për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumit Shkumbin janë përdorur disa kritere: Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 për cilësinë e ujërave të ëmbla që mbështesin rritjen e peshqve (BMZ, 1995), Klasifikimi i ujërave të lumenjve sipas UNECE, Kritere të vlerësimit të cilësisë mjedisore të Institutit për studimet e Ujërave të Norvegjisë si dhe të Autoritetit të Kontrollit të Ndotjeve të Norvegjisë të vitit 1997 (Bratli, 2000). Duke u mbështetur në parametrat fiziko-kimik, është bërë vlerësimi i përgjithshëm i cilësisë së ujërave. Si përfundim mund të themi së ujërat e këtij lumi kanë kryesisht ndikim nga burimet pikësore (ujëra urbane, industriale, kimikateve të shkarkimeve bujqësore) si dhe burimet jo-pikësore (pesticide, mbetje impiantesh, damba). Ujërat e lumit Shkumbin ruajnë gjendjen fiziko-kimike të cilësisë të mirë, për stacionet Sh 1 dhe Sh 2, të cilësisë mesatare për stacionet Sh 3, Sh 4 & Sh 8 dhe të cilësisë së keqe për stacionet Sh 5, Sh 6 & Sh 7.

(*) Ky material është përgatitur për këtë buletin nga Dr. Elvin Çomo.

Për të lexuar buletinet e tjera jeni të mirëpritur të vizitoni faqen përkatëse, duke klikuar në link-un e IGJEUM-it.

http://www.geo.edu.al

Ky "Buletin Mujor Klimatik" u përgatit nga Departamenti i Klimës dhe Mjedisit të IGJEUM-UPT.
Tiranë © 2017.

ISSN 2521-831X
09
9 772521 831005